



Fondi i Sigurimeve të Depozitave në Kosovë (FSDK) shpall:

Konkurs për vend të lirë të punës

Titulli: Zyrtar(e) i/e Lartë i Teknologjisë së Informacionit

Njësia: Teknologjia Informative (TI)

Raporton tek: Drejtori Menaxhues

Kohëzgjatja e punësimit: Me afat të pacaktuar

Niveli: Niveli – I

Zyrtari i Lartë i Teknologjisë së Informacionit është përgjegjës për administrimin, mirëmbajtjen, monitorimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së TI-së, sistemeve informative, rrjeteve, bazave të të dhënave dhe kontrolleve të sigurisë kibernetike. Pozita kërkon disponueshmëri të lartë, integritet, konfidencialitet dhe qëndrueshmërinë të sistemeve kritike FSDK-së, duke garantuar pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare, kërkesat rregullative dhe politikat e sigurisë së informacionit.

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Administron dhe mirëmban serverët fizikë dhe virtualë, sistemet e ruajtjes së të dhënave (Storage Systems), pajisjet e rrjetit dhe platformat cloud.
- Siguron funksionimin e pandërprerë të sistemeve kritike të FSDK-së, aplikacioneve dhe platformave të institucionit.
- Monitoron performancën, kapacitetin dhe disponueshmërinë e infrastrukturës së TI-së përmes mjeteve të monitorimit dhe menaxhimit.
- Planifikon dhe zbaton përditësime (updates), arnimet e sigurisë (security patches) dhe përmirësimet teknologjike.
- Menaxhon proceset e ruajtja e të dhënave (backup-it), restaurimit të të dhënave dhe zgjidhjet e Disaster Recovery (DR).
- Përgatit dhe mirëmban dokumentacionin teknik, procedurat operacionale dhe regjistrat e aktiviteteve të TI-së.
- Koordinon dhe mbështet auditimet e brendshme dhe të jashtme të sistemeve të TI-së.
- Siguron pajtueshmëri me kërkesat rregullative, standardet e sigurisë dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave.
- Kryen diagnostikimin dhe zgjidhjen e incidenteve teknike që lidhen me harduerin, softuerin, rrjetin dhe sistemet operative.
- Menaxhon llogaritë e përdoruesve, autentifikimin, autorizimin dhe kontrollet e qasjes në sisteme.

- Bashkëpunon me furnitorët dhe partnerët teknikë për implementimin dhe mirëmbajtjen e zgjidhjeve teknologjike.
- Zbaton kontrollet dhe standardet e sigurisë së informacionit në përputhje me politikat institucionale dhe bazuar në vlerësimin periodik nga kompanitë profesionale të testeve të vlerësimit të cënueshmërisë (Vulnerability Assessments) dhe mbështet aktivitetet e testimit të penetrimit (Penetration Testing).
- Siguron zbatimin e praktikave më të mira për mbrojtjen e të dhënave dhe administrimin e rreziqeve të TI-së.
- Merr pjesë në projektet e transformimit digjital dhe iniciativat strategjike të TI-së.
- Kontribuon në hartimin e specifikimeve teknike dhe dokumentacionit të prokurimit.
- Mbështet proceset e testimit, implementimit dhe migrimit të sistemeve të reja.
- Kryen vlerësime pas implementimit për të siguruar funksionalitetin dhe performancën optimale të zgjidhjeve të reja.
- Bën konfigurimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e stacioneve të punës, laptopëve, serverëve, printerëve, ruterave etj.
- Bën mirëmbajtjen teknike të webfaqes zyrtare të FSDK-së, dhe mbështet teknikisht azhurimin e informacioneve të reja.
- Zbaton politikat dhe procedurat e teknologjisë informative në bazë të standardeve më të mira.
- Vepron si zyrtar kryesor i vetëm i teknologjisë informative duke mbështetë FSDK-në profesionalisht duke ofruar përkrahje teknike.
- Kryen detyra tjera sipas caktimit të Drejtorit Menaxhues të FSDK-së.

Kualifikimet e kërkuara:

- Diplomë Universitare, në fushat si: shkenca kompjuterike, elektroteknikë, teknologji informative, sisteme informative, inxhinieri kompjuterike ose fushë të ngjashme.
- Përvojë e dëshmuar (së paku 5 vite) pune profesionale në fushën e Teknologjisë Informative; (përvojë në administrimin e sistemeve, rrjeteve, sigurisë kibernetike dhe infrastrukturës së TI-së; përvoja në sektorin bankar, financiar ose në institucione me kërkesa të larta rregullative konsiderohet avantazh).
- Certifikime profesionale (certifikime të preferuara).
- Microsoft Certified.
- Cisco CCNA/CCNP.
- Njohuri për: SQL, Oracle, T-SQL, ose certifikime ekuivalente.
- Njohuri të mirë të gjuhës Angleze me shkrim dhe në të folur.

Njohuritë dhe Aftësitë Teknike:

- Administrimi i sistemeve Windows Server.
- Menaxhimi i rrjeteve LAN/WAN, TCP/IP, VPN, Firewall dhe IDS/IPS.
- Menaxhimi i Active Directory, dhe Identity & Access Management (IAM).
- Administrimi i bazave të të dhënave SQL Server, Oracle.
- Backup, Disaster Recovery dhe Business Continuity Management.
- Administrimi i mjediseve cloud.

Kompetenca Profesionale:

- Analizë dhe zgjidhje e problemeve komplekse teknike.
- Menaxhim i incidenteve dhe reagim në situata kritike.
- Hartim dhe mirëmbajtje e dokumentacionit teknik dhe raportime.
- Orientim drejt cilësisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm.

Kompetenca Personale:

- Integritet dhe konfidencialitet i lartë profesional.
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe bashkëpunimi.
- Mendim analitik dhe kritik.
- Menaxhim efektiv i kohës dhe prioriteteve.
- Fleksibilitet dhe përshtatje ndaj ndryshimeve teknologjike.
- Qasje fleksibile ndaj detyrave të ndryshme dhe orarit të punës.

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë dokumentet në vijim:

1. CV të detajuar.
2. Letrën motivuese ku theksohet interesimi për pozitën.
3. Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it; Kopje të certifikatave profesionale.
4. Dëshmitë e përvojës punës (kontrata të punësimit ose referencave të lëshuara nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës).
5. Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti) për periudhën përkatëse.
6. Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Republikës së Kosovës.

Si të aplikoni:

- Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është **03 Gusht 2026**.
- Mund të aplikoni përmes postës elektronike në adresën: komisioni@fsdk.org duke bashkangjitur komplet dosjen, ose t'a dorëzoni në zarf në zyret e FSDK-së (adresa: Rr. Bekim Fehmiu nr.31, Kati i I-rë, Lakërishtë”).
- Kandidatët e përzgjedhur për testim do të njoftohen brenda 15 ditëve kalendarike nga data e mbylljes së konkursit për ditën e testimit.
- Kandidatët e përzgjedhur për intervistë do të informohen brenda 10 ditëve kalendarike pas datës së testimit.

Aplikacionet e pa kompletuara me 6 dokumentacionet e lartpërmendura nuk do të merren parasysh